VENDIM
Nr.19, datë 29.7.2022

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror', i ndryshuar", kreu III, neni 13, pika "b", në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'sekret shtetëror'", kreu II, neni 4, pikat "a", "c", dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, "Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 'Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'sekret shtetëror'", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'sekret shtetëror', në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'sekret shtetëror', i ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 19, datë 29.7.2022, si më poshtë:

Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. **Libri i evidencës së punëtorit operativ në zonë nr. 57**, me 227 (dyqind e njëzet e shtatë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dokumenti i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

2. **Libri i evidencës së punëtorit operativ në zonë nr. 68,** me 225 (dyqind e njëzet e pesë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dokumenti i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

3. **Libri i evidencës së punëtorit operativ në zonë nr. 2754**, me 280 (dyqind e tetëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dokumenti i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETARE
Gentiana Sula